



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës/Direkcija za Obrazovanju i Kulturu

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, dhe duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën E Kosovës Nr. 04/L-32 si dhe në Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË SHKOLLËS
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2018/2019 - AFATI I GUSHTIT -**

Nr.	Shkolla	Lëmia dhe profili	Nr.i paraleleve	Nr. i nxënësve	Gjithsej
1	Shkolla e Mesme Ekonomike	Ekonomi- Banka dhe sigurime	1	30	30

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

Kushtet e regjistrimit:

Për regjistrim nxënësve në klasën e 10-të, në Shkollën e Mesme Ekonomike për vitin shkollor 2018/19, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në Shkollën e Mesme Ekonomike në Llabjan duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën/Ekstraktin e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për vitin shkollor 2018/2019, bëhet më datën 20,22,23, Gusht 2018. në lokalet e shkollës duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen me datën 25.8.2018.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi}(kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet me mesataren e notave të kl. 6 - 9 të $(5+5+5+5) = 20$; $20 : 4 = 5$)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

3

3. Renditja e lëndëve me prioritete sipas profileve në shkolla profesionale

Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë 25
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25
3. Shkenca shoqërore 25
4. Shkencat natyrore 25

$$25 \times 1.2 = 30 \text{ pikë}$$

$$25 \times 0.6 = 15 \text{ pikë}$$

$$25 \times 0.4 = 10 \text{ pikë}$$

$$25 \times 0.2 = 5 \text{ pikë}$$

Në Novobërdë
Më, 20.08.2018



Drejtori i DAK-ut
Adem Abazi